

RREGULLORE PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN, NJOHJEN DHE HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN E ENERGISË ELEKTRIKE

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 20 dhe 39, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe në përputhje me “Rregulloren e Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”.

Neni 2 Qëllimi i Rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurat për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, duke specifikuar rregullat dhe kërkesat për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë Rregullore, termat e mëposhtëme do të kenë këto kuptime:

“**Aplikues**” është çdo person që aplikon për kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.

“**Aplikimi**” do të thotë dokumentat e parashikuara në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje të paraqitura të plotësuara në përputhje me këto nene nga një aplikues, si dhe kërkesat dhe dokumentat e paraqitura sipas nenit 11,15, 16, 17 të kësaj rregulloreje.

“**Refuzim i aplikimit**” do të thotë vendimi i Bordit të ERE-s i marrë në përputhje me këtë rregullore për moslicencimin, mosrinovimin e licencës, mospranimin e modifikimeve të propozuara apo mospranimin e transferimit të plotë/të pjesshëm të licencës.

“**Pranimi i aplikimit**” do të thotë vendimi i Bordit të ERE-s i marrë në përputhje me këtë rregullore për licencimin, modifikimin, transferimin, rinovimin e licencave në sektorin e energjisë elektrike.

“**Bordi**” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe Ligji nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

“**ERE**” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, përgjegjës për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjet e cituara më sipër dhe aktet nënligjore në fuqi.

“**Licencë**” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit të cituar më sipër.

“**I Licencuar**” do të thotë një person i pajisur me licencë për veprimtari të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

“**Person**” do të thotë çdo person juridik, që ushtron veprimtari në sektorin e energjisë elektrike.

“**Përfaqësues me prokurë/autorizim**” do të thotë një person fizik/juridik që aplikon për një licencë në emër të aplikuesi, sipas aktit përkatës të përfaqësimit.

“**Staf teknik**” do të thotë staf administrativ, ligjor apo inxhinierik, dhe/ose mbështetës, në funksion të veprimtarisë së licencuar.

“**Dokumentacion thelbësor**” do të thotë çdo leje/autorizim/miratim e lëshuar nga autoritetet/organet përgjegjëse, që është i domosdoshëm për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

Neni 4 Licencat

1. ERE lëshon licenca për veprimtaritë e mëposhtëme:
 - a. Prodhimin e energjisë elektrike;
 - b. Operimin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike;
 - c. Operimin e Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike;
 - d. Furnizimin e energjisë elektrike;
 - e. Tregtimin e energjisë elektrike;
 - f. Operimin e Tregut të energjisë elektrike;
 - g. Sistemet e mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike;
2. Për operimin e një linje direkte nuk nevojitet licencë transmetimi apo shpërndarjeje.
3. Nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike:
 - a. vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar, ose kur lidhja me rrjetin kombëtar bëhet për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së tij të prodhimit;
 - b. prodhuesit, përfshirë edhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW.
4. Për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti Anëtar të Bashkimit Europian, ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator, si dhe me kusht që ato të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar si dhe informacionin e përcaktuar në Shtojcën 1/K, të këtyre rregullave.

5. Në rast se rregullatori vendos të njohë ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, shoqëria që do të ushtrojë këto veprimtari do të konsiderohet si e licencuar në mbështetje me legjislacionin në fuqi.
6. ERE do ti përgjigjet kërkesës për njohje licence me miratim ose jo brenda 30 ditëve.
7. Tregtarët dhe Furnizuesit e huaj të cilëve do t'u njihet licenca nga ERE, do të regjistrohen në një seksion të veçantë të Regjistrit të Licencave të parashikuar në nenin 19 të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Kohëzgjatja e Vlefshmërisë së Licencës

1. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencave të lëshuara nga ERE për veprimtaritë e parashikuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, përcaktohet nga ERE, brenda kufijve të mëposhtëm:
 - a. Prodhimin e energjisë elektrike deri në 30 vjet;
 - b. Operimin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike deri 30 vjet;
 - c. Operimin e Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, deri në 30 vjet;
 - d. Furnizimin me energji elektrike, deri në 5 vjet;
 - e. Tregtimin e energjisë elektrike, deri në 5 vjet;
 - f. Operimin e Tregut të energjise elektrike, deri në 5 vjet;
 - g. Sistemet e mbyllura të shperndarjes së energjisë elektrike, deri në 5 vjet.
2. Për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave.

KAPITULLI II

PROCEDURAT E APLIKIMIT

Neni 6

E Drejta për të Aplikuar për një Licencë

Ka të drejtë të aplikojë për një licencë të lëshuar nga ERE, çdo person që ka selinë e tij në Shqipëri, dhe me objekt të veprimtarisë veprimtarinë e kërkuar për licencim. Çdo person i huaj duhet të krijojë një shoqëri sipas legjislacionit në fuqi, me objekt veprimtarie veprimtarinë e kërkuar për licencim nga ERE për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës.

Neni 7

Delegimi i të Drejtave të Aplikuesit

1. Aplikuesi mund të caktojë një individ/person, si përfaqësues me prokurë/autorizim, i cili do ta përfaqësojë atë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin, brenda kompetencave të dhëna në aktin e përfaqësimit për këtë qëllim.
2. Shfuqizohet

3. Detyrat e të përfaqësuarit janë:

- a. të paraqesë aplikimin për një licencë, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas neneve 8, 9, 11,15,16 dhe 17 të kësaj Rregulloreje;
- b. të paraqesë të dhëna dhe informacion shtesë të kërkuar nga ERE gjatë shqyrtimit të aplikimit për licencë.

Neni 8

Paraqitja e aplikimit

1. Aplikimi ka të bëjë me plotësimin e shtojcave përkatëse sipas llojit të aplikimit, që referohen në nenin 9, si dhe dokumentacionit që përcaktohet në nenet 9, 15, 16 dhe 17 të kësaj Rregulloreje.
2. Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin A të kësaj rregullore.
3. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, original ose kopje e njëzuar me dokumentin origjinal, ose me nënshkrim/vulë elektronike në rastin kur këto aplikohen. Vërtetimet dhe deklaratat duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 (një) muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.
4. Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.
5. Dokumentacioni që depozitohet në formën e deklaratës nga aplikuesi, duhet të jetë i nënshkruar dhe/ose vulosur prej tij.
6. Për centralet të cilat përdorin energjinë valore të detit dhe/ose energjinë e baticave dhe zbaticave paraqiten të njejtat dokumenta të aplikueshme si për HEC dhe në përputhje me kuadrin ligjor.

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë.

1.1 Aplikuesi duhet të plotësojë formatin e aplikimit, sipas përcaktimeve të Shtojcës 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

1.2 Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin juridik dhe administrativ si më poshtë:

- a. ekstraktin historik të regjistrir tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- b. vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për shoqërinë, administratorin/administratorët e saj;
- c. strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar;
- d. në rast se aplikuesi do të caktojë një përfaqësues, duhet të depozitojë në ERE aktin e përfaqësimit (prokurë/autorizim).

1.3 Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin financiar dhe fiskal si vijon:

- a. vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- b. bilancin financiar të 3 (tri) viteve të fundit/ose kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë e krijuara rishtazi), të audituar (kur kjo kërkohet nga ligji) dhe/ose dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe mbështetjen financiare (financim i vetë aplikuesit, kredi ose garanci bankare, donacion, etj.) për ushtrimin e veprimtarisë, sipas llojit të aplikimit, bazuar në këtë dokumentacion. (Në në rastin e veprimtarisë së tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi)
- c. planin e biznesit, ku të ketë përcaktime në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e projektit/ushtrimit të veprimtarisë së licencuar).

2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- a. formatin e plotësuar me të dhënat teknike sipas Shtojcës 2;
- b. marrëveshjen e koncesionit/autorizimin apo çdo formë tjetër të marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi;
- c. miratimin e operatorit të rrjetit (OST sha, ose OSSH sha) për lidhjen e centralit/centraleve me rrjetin elektrik;
- d. lejen e përdorimit të burimit ujqor për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet;
- e. miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë mjedisore, Leje);
- f. miratimin e projektit të digës nga Komiteti Kombëtar i Digave (në rastet e objekteve me digë).

2.2 Për t'u pajisur me licencë për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- a. formatin e plotësuar me të dhënat teknike sipas Shtojcës 3;
- b. diagramën e sistemit të transmetimit që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës në format A1;
- c. planin e zhvillimit të rrjetit;
- d. numrin e punonjësve të kategorizuar sipas profesioneve.

2.3 Për t'u pajisur me licencë për operimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- a. formatin e plotësuar me të dhënat teknike sipas Shtojcës 4.
- b. diagramën e sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës;
- c. planin e zhvillimit të rrjetit;
- d. plan-veprimin për uljen e humbjeve teknike dhe joteknike;
- e. plan-veprimin për permirësimin e cilësisë së shërbimit;

- f. numrin e punonjësve të kategorizuar sipas profesioneve;
- g. të dhëna për matjen dhe për sistemet IT.

2.4 Për t'u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- a. informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në GWh) të parashikuar për t'u furnizuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës;
- b. informacion mbi sistemin IT me të cilin do të operojë veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi, me qëllim realizimin e procesit të faturimit për klientët;
- c. informacion mbi disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, me adresat përkatëse të vendndodhjes së tyre;
- d. informacionin mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët.

2.5 Për t'u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në GWh) të parashikuar për t'u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës.

2.6 Për t'u pajisur me licencë për operimin e tregut të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- a. numrin e punonjësve të kategorizuar sipas profesioneve;
- b. informacion për zotërimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për operimin e tregut sipas Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe akteve të tjera për këtë qëllim;
- c. informacion dhe dokumentacion që vërteton mundësinë për të zhvilluar të gjitha procedurat operacionale, kontraktuale ose marrëdhëniet e aksesit, përfshirë shërbimet për likuidimet (clearing).
- d. rregulloret përkatëse të miratuara nga organet drejtuese që lidhen me mekanizmin për mbikëqyrjen e tregut, procedurat dhe kontrollat për mbrojtjen e informacionit konfidencial;
- e. çdo dokumentacion tjetër që lidhet me bashkëpunimin në kuadër të veprimtarisë së operimit të tregut të energjisë elektrike.

2.7 Për t'u pajisur me licencë për veprimtarinë e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- a. elementet e sistemit të mbyllur të shpërndarjes;
- b. burimin e furnizimit me energji elektrike të këtij sistemi;
- c. informacion mbi klientët e këtij sistemi, me kapacitetet e instaluara përkatëse;

Neni 10 **Shqyrtimi i Aplikimit**

1. Pasi shqyrtojnë aplikimin e paraqitur, lidhur me plotësimin e kërkesave të [nenit 8, 9, 15,16 dhe 17](#), personat e ngarkuar nga Drejtoria Përgjegjëse përgatisin një relacion ku i propozojnë Bordit të ERE-s fillimin ose jo të procedurës për shqyrtimin e aplikimit në përputhje me afatet

- e përcaktuara në Rregulloren për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s dhe në këtë rregullore.
2. Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregullore duke plotësuar kërkesat dhe dokumentat e kërkuara në të. Në të kundërt, Bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurës për shqyrtimin e aplikimit.
 3. Bordi i ERE-s mund të vendosë për fillimin ose jo të procedurës për shqyrtimin e aplikimit bazuar në legjislacionin në fuqi.
 4. ERE mund të fillojë procedurën për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshtuara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin e shoqërisë do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.
 5. Në rast **mosfillimi të procedurës**, ERE do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit dhe duke i dhënë udhëzimet e nevojshme brenda **7 ditëve** nga marrja e vendimit.
 6. **Shfuqizohet.**
 7. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.
 8. Në rast të miratimit të fillimit të procedurës për shqyrtimin e aplikimit, brenda 2 **ditëve** nga marrja e vendimit, **ERE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit dhe në median e shkruar** për dy ditë me rradhë një njoftim për aplikimin e paraqitur në **dy gazeta** të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë. Çdo njoftim për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike do të përmbajë shkurtimisht të dhënat lidhur me kapacitetet e instaluar vendodhjen dhe territorit ku kryehet veprimtaria e licencuar.
 9. Njoftimi përmban:
 - a. një informacion të shkurtër për aplikimin e paraqitur;
 - b. një njoftim që paraqitja e objeksioneve ose ankesave nga personat e interesuar mund të behët në ERE brenda afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.
 10. Duke nisur nga dita e parë e publikimit të njoftimit, ERE do të presë kundërshtimet e mundshme për këtë aplikim, për një afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga data e parë e publikimit të njoftimit për aplikimet për veprimtarinë e prodhimit për centralet e lidhura me rrjetin e transmetimit.
 11. Për aplikimet për veprimtarinë e prodhimit për centralet e lidhura drejtpërdrejt me rrjetin e shpërndarjes dhe për aplikimet e tjera sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, afati i përcaktuar në pikën 10, do të jetë 10 (dhjetë) ditë.
 12. Me kërkesë me shkrim, aplikuesi mund të kërkojë që të mbahen konfidenciale informacione ose dokumente të depozituara prej tij në kuadër të aplikimit, që mund t'i shkaktojnë atij dëm tregtar. Ky dokumentacion duhet të specifikohet prej tij, së bashku me arsyet e mosbërjes publike. Përndryshe konsiderohet se kërkuuesi nuk e kërkon një kufizim të tillë. Kjo kërkesë, në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi mbi informacionin konfidencial dhe të drejtën e informimit, do të mbahet në konsideratë në vijim, në rast të interesit të palëve të treta për të aksesuar dokumentacionin e aplikimit.

13. Në çdo rast, ERE njofton aplikuesin për objeksionet e paraqitura ndaj aplikimit për të cilin kanë filluar procedurat e licencimit dhe kërkon sqarime nga aplikuesi për objeksionet e paraqitura nga palët e interesuara.

Neni 11

Plotësimi dhe paraqitja e informacionit shtesë

1. Duke filluar nga data e publikimit të parë në media të njoftimit për aplikimin deri në përfundim të afateve të përcaktuara në nenin 10, pika 10, dhe 11, ERE mund t'i kërkojë aplikuesit të paraqesë informacion shtesë, në formën dhe përmbajtjen e caktuar brenda një afati të caktuar, lidhur me çdo çështje që ERE e konsideron të nevojshme.
2. Nëse aplikuesi nuk paraqet informacionin shtesë brenda afatit, formës dhe përmbajtjes së caktuar, kjo do të përbëj kusht për refuzimin e aplikimit.

Neni 12

Analizimi i dokumentacionit dhe propozimi përfundimtar

1. Pas përfundimit të periudhës së marrjes së objeksioneve sipas nenit 10, pika 10 dhe 11 të kësaj rregullore, Drejtoria/Drejtoritë Përgjegjëse do të analizojë të gjitha objeksionet e mundshme të dërguara nga palë të treta, dokumentet e depozituara (aplikimi) nga aplikuesi si dhe çdo informacion shtesë të marrë me kërkesë të ERE-s, nëse përputhen me dispozitat e kësaj rregulloreje **apo legjislacionit në fuqi**.
2. Pas kontrollit të dokumentacionit, Personi i ngarkuar nga Drejtoria/Drejtoritë Përgjegjëse do t'i paraqesi Bordit të ERE-s një **relacion** duke sugjeruar pranimin ose refuzimin e aplikimit përkatës si dhe arsyetimet përkatëse në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Vendimmarrja e Bordit

1. Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e objeksioneve ose ankesave, Bordi i ERE-s shqyrton kërkesën për aplikim dhe relacionin e paraqitur për këtë aplikim nga personi/at e ngarkuar nga Drejtoria Përgjegjëse në përputhje me kriteret e specifikuar në nenin 38 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe kësaj rregullore.
2. Në marrjen e vendimit për licencimin ose refuzimin e licencimit të një shoqërie aplikuese, Bordi i ERE-s merr në konsideratë kriteret e mëposhtme:
 - a. plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion shtesë të ERE-s;
 - b. vendndodhjen dhe territoret në të cilat do të kryhet veprimtaria;
 - c. funksionimin e sigurtë dhe të qëndrueshme të impianteve të paisjeve dhe/ose të rrjetit;
 - d. kërkesat për llojin e burimeve parësore të energjisë;
 - e. kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, jetën e qytetarëve, pasurinë, shëndetin dhe rendin publik;

- f. kërkesat financiare;
 - g. mbrojtjen e mjedisit;
 - h. nxitjen e eficiencës së energjisë në sektorin e energjisë elektrike;
 - i. nxitjen e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
 - j. nxitjen e tregut konkurrues të energjisë elektrike dhe parimet e kostos më të ulët në furnizimin me energji elektrike;
 - k. efektin ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Në marrjen e vendimit të tij, Bordi i ERE-s shqyrton:
- a. aplikimin, si dhe çdo informacion shtesë të paraqitur nga aplikuesi
 - b. çdo objeksion ose ankesë të paraqitur nga personat e interesuar;
 - c. relacionin e hartuar nga personi/at i/e ngarkuar nga Drejtoria Pergjegjëse.

Neni 14

Pranimi ose Refuzimi për Licencim i Aplikuesit

1. Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike brenda 60 diteve nga data e publikimit të parë në shtyp të njoftimit për aplikimin për licencë, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.
2. Për centralet e lidhur drejtëpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes dhe për të gjitha licencat e tjera, Bordi merr vendim jo me vonë se 30 dite nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp për aplikimin për licencë, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.
3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
4. Për rastet e tjera të aplikimit zbatohen afatet dhe procedurat e përshkruara në nenin 15, 16 dhe 17.
5. Vendimi i komunikohet aplikuesit nëpërmjet një njoftimi me shkrim dhe do të përmbajë arsyetimin përkatës në të cilin është bazuar vendimmarrja.
6. Vendimi i ERE-s i dhënë sipas kësaj rregullore publikohet në Fletoren Zyrtare.
7. Vendimi i ERE-s mund të apelohej në Gjykatën Kompetente nga aplikuesi ose çdo palë e tretë e interesuar.
8. Në rast se i licencuari humbet dokumentin origjinal të licencës të lëshuar nga ERE, ai mund të bëjë kërkesë në ERE për lëshim duplikatë licence, kundrejt një pagese siç përcaktuar në Aneksin A të kësaj Rregulloreje. Të licencuarit do t'i lëshohet dublikata e licencës vetëm pasi të vërtetohet se ai ka kryer pagesën përkatëse.
9. ERE mund marrë vendim me kusht kur gjykon se ndonjë nga dokumentet e paplotësuar nuk është thelbësore dhe i licencuari merr përsipër ta përmbushë atë brenda një periudhe të caktuar kohore të përcaktuar në vendim. Plotësimi/mosplotësimi i kushtit sipas përcaktimit të vendimit të Bordit të ERE-s do të përbëjë shkak për rishikimin e vendimit.

10. Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

KAPITULLI III MODIFIKIMI, RINOVIMI, DHE TRANSFERIMI I LICENCËS

Neni 15 Modifikimi i Licencës

1. Në përgjigje të çdo kërkesë të të licencuarit ose me iniciativën e vet, ERE mund të modifikojë termat dhe kushtet e një licence, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.
2. ERE mund të vendosë modifikimin e licencës në rastet e **mëposhtme**:
 - a. me iniciativën e saj kur ka ndryshime të rrethanave të lëshimit të licencës (kuadri ligjor, kushtet e kontratës koncesionare, vendime të gjykatës) ose të disa ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin e energjisë elektrike ose tregun e energjisë elektrike,
 - b. me kërkesë të të licencuarit.
3. Nëse ERE vendos të ndryshojë një licencë, duhet t’i lëshojë të licencuarit një licencë me përmbajtje të ndryshuar, duke shfuqizuar pjesët e ndryshuara të licencës së mëparshme.
4. Në rastin e modifikimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ky i fundit duhet të depozitojë në ERE:
 - a. formatin e plotësuar të aplikimit sipas Shtojcës 1;
 - b. informacion ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës dhe çdo parametër teknik që ndryshon;
 - c. vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës;
 - d. miratimin/qëndrimin e Autoritetit Kontraktues (ministria përgjegjëse);
 - e. miratimin/qëndrimin e organeve përgjegjëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit;
 - f. miratimin/qëndrimin e organeve përgjegjëse të menaxhimit të burimeve ujore, në rastet e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet;
 - g. miratimin/qëndrimin e operatorit të rrjetit në lidhje me këtë modifikim, në rastet e ndryshimit të kapacitetit të instaluar.

Neni 16 Rinovimi i licencës

1. Në rast të interesit për rinovimin e licencës, i licencuari duhet të paraqesë aplikimin përkatës në ERE për rinovim jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:
 - a. formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1.
 - b. çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë;
 - c. informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

2. ERE mund të kërkojë nga shoqëria çdo infomacion shtesë të konsideruar të nevojshëm për procesin.
3. Kriteret për marrjen e vendimit nga Bordi janë të njëjta si në rastin e një licencimi.
4. ERE publikon në median e shkruar një njoftim për aplikimin për rinovimin e licencës sipas të njëjtave procedura që aplikohen dhe për kërkesat për licencim në sektorin e energjisë.
5. Bordi mund të marrë në konsideratë në rastin e rinovimit të licencës edhe përmbushjen e kushteve të licencës në veprimtarinë e licencuar nga aplikuesi.
6. Bordi do të marrë vendimin për rinovim ose jo të licencës jo më vonë se 20 ditë nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi, konformë kësaj rregullore.
7. Të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE. Mosplotësimi i këtij kushti përbën shkak për sanksionim sipas parashikimeve të nenit 5 të Rregullores *Për vendosjen e Gjobave dhe Kushtet e lehtësimit prej tyre*.
8. Në rast se i licencuari nuk paraqet në ERE aplikim për rinovimin e licencës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ose ERE merr vendim për refuzimin e kërkesës së të licencuarit për rinovim të licencës, kjo e fundit e humbet vlefshmërinë me përfundimin e afatit të kohëzgjatjes së saj dhe hiqet nga regjistri i të licencuarve të ERE-s. Në këto rrethana, në rast të interesit për të ushtruar sërish veprimtarinë, duhet të paraqitet aplikim për licencim nga e para, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës

1. Me kërkesë të të licencuarit ERE dhe/ose me inisiativen e saj mund të transferojë plotësisht dhe pjesërisht licencën e një të licencuari në përputhje me Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
2. Në rastet e transferimit të plotë të licencës, i licencuari duhet të paraqesë në ERE dokumentet e mëposhtme:
 - a. formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1.
 - b. informacion ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës;
 - c. informacion mbi ndikimet e pritshme të transferimit të licencës;
 - d. marrëveshjen e nënshkruar mes të licencuarit dhe personit tek i cili do të transferohet licenca, ku të shprehet vullneti për këtë transferim.
 - e. deklaratë me shkrim e personit tek i cili do të transferohet licenca, ku të shprehet gatishmëria për të vijuar me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar dhe kontributi financiar që do të vendoset në dispozicion të veprimtarisë;
 - f. miratimin/qëndrimin e Autoritetit Shtetëror Përgjegjës, në rast se transferimi kushtëzohet me një miratim/qëndrim të tillë.
3. Në rastin e transferimi të pjesëshëm të aseteve, ERE zbaton të njëjtat procedura si për transferimin e plotë të përshkruar në pikën 2 por para se të vendosë për licencimin e personit tek i cili do të transferohen pjesërisht asetet, do të kryejë modifikimin e licencës të personit të licencuar që ka kryer transferimin e pjesëshëm të aseteve.
4. Në rastin e kërkesës nga i licencuari për transferimin e licencës, jo sipas rastit të parashikuar në pikën 2 dhe 3 të këtij neni, i licencuari duhet të paraqesë në ERE këto dokumenta:

- a. formatin e aplikimit sipas nenit 9, pika 1;
 - b. një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës;
 - c. vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës;
 - d. Vërtetimin e pagesës së aplikimit;
 - e. Vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë për miratimin e transferimit të kuotave/aksioneve të shoqërisë.
5. Në rastet e transferimit të plotë ose të pjesshëm të licencës, që shoqërohet dhe me transferimin e aseteve fikse të të licencuarit, aplikimi për këtë transferim duhet të bëhet paralelisht me aplikimin për transferimin e licencës, sipas përcaktimeve të Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit.
6. Pas miratimit të fillimit të procedurave për shqyrtimin e aplikimit për transferimin e licencës ERE publikon në median e shkruar një njoftim për aplikimin për transferimin e licencës sipas të njëjtave procedura që aplikohen dhe për aplikimet për licencim në sektorin e energjisë.
